



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.64 dt.15.05.1997

**PER  
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN MARS 1997.**

Në bazë të legjislacionit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.15.05.1997, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Sektorit të Mbrojtjes Shoqërore.

**VENDOSI:**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **11.728 familje** me një fond prej **25.018.263 lekë**. Për çdo Njësi Administrative sipas relacionit.
2. Të përfitojnë nga fondi shtesë ndihmë ekonomike **40 familje** me një fond prej **140.000 lekë**.
3. Miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje për muajin mars.
4. Të dalin nga skema e ndihmës ekonomike **80 familje** sipas pasqyrave të bashkëngjitura.
5. Të rifuten në skemën e ndihmës ekonomike familjet e cituara në relacion.
6. Të trajtohen në mënyrë të diferencuar duke i afruar në nivelin maksimal Ana Neli familje me 9 anëtar, ndihmë ekonomike e plotë, Nj.A.6, 5.000 lekë, Liri Brace familje me 1 anëtar, ndihmë ekonomike e plotë, Nj.A.11 me maksimalen për familjet me 1 anëtar. Afërdita Hado familje me 2 anëtar, ndihmë ekonomike e pjesshme, Nj.A.7, 861 lekë.
7. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike si rast i veçantë Armir Alia familje me 3 anëtar ,Nj.A.2.
8. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike përkohësisht Kostandin Manushi.

9. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **1.443 persona** me aftësi të kufizuar dhe **57 persona** për përkujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar me një fond gjithsej prej **4.881.466 lekë**.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**